



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF  
SUHAREKA

13.01.2021

|                                                                                                                                      |                         |                               |                            |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS<br>REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUHAREKA<br>REPUBLIC OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA |                         |                               |                            |
| NË DORËZIM: PRIMLJENO - RECEIVED                                                                                                     |                         |                               |                            |
| Nësta org.<br>Org. Jedinica<br>Org. Unit                                                                                             | Numri<br>Broj<br>Number | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Vlera<br>Vrednost<br>Value |
| 01                                                                                                                                   | 104                     | 2734                          | 2.                         |

|        |                                                                                                                                                         |                     |
|--------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|
| 11 Nr. | Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluejtshme të Komunës | Date:<br>13.01.2021 |
|--------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-61755 të datës 23.12.2020 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të procesverbalit NR.49 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 13.01.2021, LIGJI NR.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluejtshme të Komunës, në bazë të Rregullorja (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, është miratuar në mbledhjen e 20-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.06/20, datë 05.08.2020, komisionit përkatës shpall:

**ANKAND PUBLIK**  
**Nr.01/2021**

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë 15 (pesëmbdhjetë) vite të pronës së paluajtshme komunale:

1. Parcela kadastrale:- P-72116046-02050-0 sipas certifikatës Nr.5302-2020, të datës 15.12.2020 me sipërfaqe prej 503m<sup>2</sup> vendi i quajtur “Bashqe/Tregu Lopve”, zona kadastrale Suharekë, me destinim tokë jo pjellore, pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal – Suharekë, për ushtrimin e aktivitetit biznesorë.

**Dëshmitë e kërkuara:**

1. Kopja e dokumentit të identifikimit për persona Fizik
2. Certifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik)
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik – Tatimi në pronë ; për personat juridik – Taksa Komunale, dhe tatimi në pronë.
4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK (për personat juridik)

Kriteret e kërkuara;

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara.
- Çmimi fillestar për m<sup>2</sup> të parcelës - minimum 0.20€/m<sup>2</sup> në muaj.
- Çmimi më i lart vlersohet me 100% të pikëve.

*Vërejtje:*

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- OE ka të drejtë të tërhiqet nga ankandi publik jo më vonë se 3 (tre) ditë para mbajtjes së ankandit publik.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datën 28.01.2021 , zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave deri më datë 28.01.2021 deri në ora 16:00 zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë, oferta duhet të jetë e protokoluar.

Hapja e ofertave bëhet me 01.02.2021 në ora 13:30 në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave bëhet nga komisoni përkatës i Kuvendit të Komunës së Suharekës.

Informatat shtesë;

Nr. tel: 029 271 708

emrush.bytyci@rks-gov.net

**Kryesuesi i komisonit**

**Emrush BYTYÇI**

